REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

PROJEKT – VENDIM
Nr. 45 datë 23 . 07 2025
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2023, VKM Nr. 384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM Nr. 453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti*", VKM Nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*", nivelit minimal dhe maksimale të të ardhurave dhe dokumentacionit kredi të lehtësuar nga shteti që duhet të plotësojnë individet/familjet për t'u trajtuar me programin e subvencionimit. VKB Nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit të strehimit strehimit në Bashkinë Devoll*" , Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr.37 datë 25.01.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Devoll.*

PROPOZOJMË:

1.Të miratojë listen me aplikues; Znj. Erinda Përparim Agolli, Znj. Donatela Namik Hoxha, znj. Rovena Bariq Backa, z. Florenc Muamet Zyfi, z. Ardian Ylli Çobani, të cilët u përzgjodhen nga Komisioni i Strehimit si kategori përfitues në programin "Subvencioni i Interesave të Kredisë" sipas tabelës Nr. 1 bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi dhe vendimit te komisionit datë 21.07.2025.
2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kujdesit Social dhe PAK, Bashkia Devoll.
3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

Konceptoi: Sp.e.Admi të Nevojave për Strehim
L.Laçi
Pranoi: Përgj. Kujdesit Social dhe PAK
M.Bejleri
Konfirmoi: Dr.Sherbimit Social
Z.Simani
Konfirmoi bazën ligjore:
Përgj. Sek Juridik
Eriksela Avdo

KRYETAR I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

RELACION
Mbi Projekt-Vendimin
PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM Nr. 384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr. 453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*", VKM Nr. 301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB Nr.17, datë 27.02.2025 "*Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit*", nivelit minimal dhe maksimale të te ardhurave dhe dokumentacionit kredi te lehtesuar nga shteti qe duhet te plotesojne individet/familjet per tu trajtuar me programin e subvencionimit. VKB nr.2 datë 29.01.2025 për "*Miratimin e rregullores dhe funksionimin e komisionit te strehimit strehimit në bashkinë Devoll*", Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 37 datë 25.01.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë Bashkisë Devoll*"

Bazuar Nenit 48 i ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023 përfituesit nga programi i banesave me kosto të ulët:
1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët individë e familje me të ardhura vjetore neto baras ose më të ulëta se 1/6 e vlerës mesatare të banesës në treg që përfiton individi a familja, të cilat në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:
a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vjetët e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekjeje apo sëmundjeje të rëndë) ose force madhore;
b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
c) janë të zhvendosura nga banesat sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.
2. Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banesave dhe vihet në dispozicion

të programit të banesave me kosto të ulët.
2/1. Familjet, që disponojnë banesë në pronësi nën normat e strehimit dhe paraqesin kërkesë për strehim, përfitojnë kredi me interesa të subvencionuara sipas nenit 47 të këtij ligji, në masën jo më të madhe se 60% e çmimit mesatar të shitblerjes së banesës në treg, që miratohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "dh" të nenit 72 të këtij ligji.
3. Normat e strehimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4.Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Bazuar pikës 3 të Vendimit Nr. 301, datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat Sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të Ulët*"
Norma e strehimit për programet e strehimit social, në përputhje me parimet e politikave të strehimit, bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", është 30 m2 sipërfaqe neto për personin e parë. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m2 dhe llogaritet sipas formulës më poshtë:
Sipërfaqja Neto e Banesës = 20m2 + N x 10 m2 Ku: Sipërfaqja neto e banesës: është sipërfaqja e shfrytëzimit pa muret e brendshme dhe
perimetralë, e quajtur ndryshe si sipërfaqja e përdorshme ose e shkeljes.
N është numri i banorëve mbi moshën 5 (pesë) vjeç.
4. Kur në përbërje të familjes ka një a më shumë persona me aftësi të kufizuara, norma e strehimit për personin e parë është 40m2. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m2 dhe llogaritet sipas formulës:
Sipërfaqja Neto e Banesës = 30m2 + N x 10m2
Ku: 'Sipërfaqja neto e banesës' dhe 'N' kanë kuptimin si në pikën 3 të këtij vendimi.

Komisioni i Strehimit u mblodh më datën 21.07.2025 i përbërë nga 6 anëtare të pranishëm në mbledhje. Pasi morri në shqyrtim 5 (pesë) aplikimet dhe dokumentacionin e aplikuesve konstatoi se familjet:

1.Familja e znj. Erinda Agolli përbëhet nga 3 anëtarë. Kjo familje nuk zotëron banesë në pronësi. Të ardhurat neto mujore të familjes janë 99,482 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekë, të cilat rrjedhin nga puna e znj. Agolli si e punësuar në shtet, si dhe nga aktiviteti privat që ushtron bashkëshorti i saj. Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e Znj. Erinda Agolli përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Komisioni e vlerësoi dosjen me 24 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

2.Familja e znj. Donatela Hoxha përbëhet nga 3 anëtarë dhe aktualisht nuk zotëron një banesë në pronësi. Të ardhurat neto mujore të familjes 91,611 (nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e

njëmbëdhjetë) lekë që rrjedhin nga kontributi i të dy bashkëshortëve. Znj. Donatela është e punësuar si mësuese në sistemin arsimor publik, ndërsa bashkëshorti i saj punon në sektorin privat, "Euro Market". Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e Znj. Donatela Hoxha përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Komisioni e vlerësoi dosjen me 24 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

3. **Familja e znj. Rovena Backa** përbëhet nga 3 anëtarë dhe nuk zotëron banesë në pronësi. Të ardhurat neto mujore të familjes janë 82,277 (tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë. Këto të ardhura janë nga puna e znj. Rovena Backa si mësuese në sistemin arsimor publik. Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e Znj. Rovena Backa përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Komisioni e vlerësoi dosjen me 24 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

4. **Familja e z. Florenc Zyfi** përbëhet nga 2 anëtarë nuk zotëron banesë në pronësi. Të ardhurat neto mujore të familjes janë 78,525 (shtatëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë. Këto të ardhura janë nga puna e z. Florenc Zyfi si mësues në sistemin arsimor publik. Bashkëshortja nuk është e punësuar dhe familja nuk ka burime të tjera të të ardhurave. Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, Familja e z. Florenc Zyfi përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Komisioni e vlerësoi dosjen me 18 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*".

5. **Familja e z. Ardian Çobani** përbëhet nga 4 anëtarë dhe nuk zotëron banesë në pronësi. Të ardhurat neto mujore të familjes janë 97,221 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëzet e një) lekë. Këto të ardhura rrjedhin nga puna e z. Çobani, pranë subjektit "Aulona-Pol-I", si dhe nga puna e djalit të tij, Kledi Çobani, i cili ushtron detyrën e Automatiks në institucionin "Reparti Ushtarak nr. 1020". Familja përballon nevojat bazë të jetesës me këto të ardhura, por për shkak të mungesës së një banese në pronësi dhe kostove të larta të strehimit, gjendet në kushte ekonomike të vështira dhe ka nevojë për mbështetje në kuadër të programeve të kredive të buta për strehim. Duke marrë parasysh përbërjen familjare, nivelin e të ardhurave dhe mungesën e një banese në pronësi, familja e z. Ardian Çobani përmbush kriteret për t'u trajtuar me prioritet në skemat e mbështetjes për strehim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Komisioni e vlerësoi dosjen me 18 pikë sipas Sistemit të pikëzimit bazuar VKB Nr.101 datë 24.12.2021 "*Mbi miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social, të ardhurave minimale që duhet të kenë familjet*

përfituese të banesës me kosto të ulët ndërtuar nga EKB si dhe nivelit maksimal të subvencionit të qirasë".

Aplikimet për këtë program Strehimi do të qëndrojnë të hapura deri në plotësimin e të gjitha kuotave që na janë akorduar nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: Spec e Administrimit të Nevojave për Strehim
Linda Laci

Miratoi: Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
Marilda Bejleri

Konfirmoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani

Tabela Nr.1 lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Interesave të Kredisë.

Nr	Emri/Atësia/ Mbiemri	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamenti t që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Kredia Maksimale që përfiton
1.	Erinda Përparim Agolli	24	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	Familje e re		99,482	Shtet	3,256,200
2.	Donatela Namik Hoxha	24	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	Familje e re		91,611	Shtet	3,256,200
3.	Rovena Bariq Backa	18	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi			82,277	Shtet	3,256,200
4.	Florenc Muamet Zyfi	18	2	1+1	Nuk ka banesë në pronësi			78,525	Shtet	2,211,000
5.	Ardian Ylli Çobani	18	4	2+1	Nuk ka banesë në pronësi			97,221	Privat	3,256,200

KOMISIONI I STREHIMIT

1. dunda doni
2. Marilda Bejan
3. FATJANA SPAHO
4. Ylson Stefo
5. Erthisela Nicola
6. _____
7. _____

KRYETAR I KOMISIONIT

Zerina Sinani

Tabela Nr.1 lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Interesave të Kredisë.

Nr.	Emri/Atësia/Mbiemri	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamenti t që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Kredia Maksimale që përfiton
1	Erinda Përparim Agolli	24	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	Familje e re	-	99 482	shtet	3,256,200
2	Donatela Namik Hoxha	24	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	Familje e re	-	91 611	shtet	3,256,200
3	Rovena Bariq Backa	18	3	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	-	82 277	shtet	3,256,200
4	Florenc Muamet Zyfi	18	2	1+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	-	78 525	shtet	2,211,000
5	Ardian Ylli Çobani	18	4	2+1	Nuk ka banesë në pronësi	-	-	97 221	privat	3,256,200

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/